

NEWSLETTER

Mars



Një ditë në Albsig, Iden pjesë e projektit “Drejtues për një ditë” nga Junior Achievement of Albania.

Stafi i grave dhe vajzave të Albsig, vizitë turistike në Selanik me rastin e festës së 8 Marsit.

Kapni ofertat e marsit në Albsig.

20 Vite Albsig, 20 vite histori suksesi për gjiganden që transformoi tregun shqiptar të Sigurimeve.



PJESË E  KASTRATI GROUP

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.




Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP





Një ditë në Albsig, Iden pjesë e projektit “Drejtues për një ditë” nga Junior Achievement of Albania!

Në mbështetje të programit “Drejtues për një ditë” nga Junior Achievement of Albania, ishte me ne sot në Albsig, Iden. Gjimnazistja nga Tirana, e cila sot ka qenë pjesë dhe ka drejtuar kompaninë për një ditë. E reja është njohur me të gjithë drejtuesit e kompanisë dhe njëkohësisht ka parë më nga afër të gjithë punën e departamenteve të shoqërisë.

Iden Nano, 18 vjeçarja ka qëndruar përgjatë një dite në Departamentin e Marketingut dhe ka parë më nga afër punën e këtij departamenti. **“E shikoj më afër marketingut veten time në të ardhmen”**, theksoi Iden në një bashkëbisedim me ekspertin e mediave në Albsig. Ajo shtoi se e shikon veten në një të ardhme të afërt si financiere ose marketiere të zonjën.

Shumë të lumtur të jemi pjesë e projektit “Drejtues për një ditë” nga Junior Achievement of Albania. Një ndër pikat ku të gjithë mund të pajtohemi është domosdoshmëria e edukimit joformal, punës praktike dhe vullnetarizmit. Mungesa e këtyre të trijave dhe përditshmëria e sistemit të edukimit shumë lehtë mbyt ambiciet në pothuajse çdo individ. Në një treg si ky i Shqipërisë ku mundësitë e zhvillimit nuk vijnë vetë, një i ri duhet të hapë rrugën dhe t'i gjejë vetë mundësitë, shpeshherë të fshehura. Dhe për të lehtësuar sadopak këtë rrugë Albsig synon krijimin e mundësive të reja për punësim dhe vetëpunësim të të rinjve të talentuar, nëpërmjet ndërthurjes së teknikave të hershme me elementë të rinj artistikë.



Së bashku, punojmë për një të ardhme më të shëndetshme!



Stafi i grave dhe vajzave të Albsig vizitë turistike në Selanik me rastin e festës së 8 Marsit.

Festa e 8 Marsit ka mbledhur bashkë gjithë stafin e grave dhe vajzave të Albsig, Albsig Jetë, Albsig Invest në një fundjavë turistike në Selanik. Ka qenë dëshira e vetë stafit të grave dhe vajzave të Albsig që të bëjnë një tur të shkurtër në Selanik. Dhe kjo dëshirë është plotësuar menjëherë nga drejtuesit e kompanisë. I gjithë stafi i grave dhe vajzave të Albsig, Albsig Jetë dhe Albsig Invest janë organizuar pikërisht në fundjavën e festës së 8-marsit dhe kanë organizuar dhe turin e shkurtër për këtë sezon turistik. Nisja ka vijuar në mëngjes herët drejt pikës kufitare të Kapshticës. Ndalesat rrugës për pushimin e mëngjesit. Vazhdimi i rrugës drejt kufirit ka qenë shumë harmonik dhe i gëzuar mes këngëve e valleve mes kolektivit. Përfundimi i procedurave kufitare dhe doganore ka qenë pak me vonesa po sërish kjo gjë është suportuar mjaft mirë nga stafi i Albsig. Mbërritja në Selanik ishte rreth orës 17.00. Akomodimi nëpër dhoma, darka në hotel dhe koha e lirë për argëtim ka qenë e mbushur plot e për plot me vizita e shëtitje. Kthimi në hotel dhe darka.

Ka qenë një ndër turet më të mira të realizuar me të gjithë stafin e grave dhe vajzave të Albsig. Është e disata herë që stafi i grave dhe vajzave të Albsig me rastin e festës së 8 Marsit organizon ture të tilla. Ne, në Albsig besojmë se "Klienti është mbret" dhe "stafi është i shenjtë" për këtë edhe shërbimi i mirë vjen nga marrëdhëniet e forta që krijohen tek ekipi ynë, nga përkushtimi i çdo dite për të dhënë më të mirën dhe nga fryma e përfshirjes dhe solidaritetit me klientët. I gjithë stafi i Albsig që nga dita e parë e punës dhe gjatë gjithë viteve të përvojës, sfidojmë veten për të qenë gjithmonë në lartësinë e duhur, zhvillohemi për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave të çdo klienti, sepse i konsiderojmë si partnerët tanë më të vlefshëm. Vlerat tona na bashkojnë e na bëjnë më të fortë për të përballuar çdo situatë.

Kapni ofertat e marsit në Albsig.



Muaji mars është gjithmonë një kohë e bukur për të përjetuar freski, bashkë me rikthimin e diellit edhe festat bëhen më të bukura. Në këtë muaj të shënuar nga data të veçanta, Albsig rikujton forcën dhe kurajon për zbulimin e vetvetes dhe eksplorimin e trendeve të reja. Albsig ka festuar me femrat, dhe ka sjellë për to një buqetë ofertash në ditën e tyre të 8 Marsit përmes produkteve që gjithësecila nga gratë dhe vajzat ka blerë atë ditë në albsig ka përfituar ulje në çdo produkt. Çdo kliente grua që e viziton www.albsig.al online por edhe në pikat e tyre të shitjes do të përfitojë një zbritje në blerjet e tyre. Le të festojnë gratë që zgjedhin të jetojnë jetën sipas kushteve të tyre dhe të ndajnë historitë e tyre unike me botën.

Shoqëria e Sigurimeve Albsig po vazhdon fuqishëm me mesazhin sensibilizues për ruajtjen dhe rëndësinë e të drejtave të çdo femre. Edhe ju mund t'i bashkoheni kësaj kauze, dhe të përfitoni zbritje ndër të tjera për blerjet tuaja përgjatë muajit mars në Albsig. Duke ndaluar në pikat e shitjes fizike në Albsig ose edhe duke aplikuar e porositur online sigurimin e kërkuar ju mund të përfitoni uljet e propozuara nga Albsig.

Por aventura e blerjes nuk përfundon këtu. Albsig ofron një seri të vazhdueshme të ofertave në produktet tuaja të preferuara duke ofruar zbritje të konsiderueshme në të gjitha pikat e tyre shitëse dhe në platformën online.



Bli Online
albsig.al



20 Vite Albsig, 20 vite histori suksesi për gjiganden që transformoi tregun shqiptar të Sigurimeve.

Plot 20 vite në treg, me një histori të mbushur me profesionalizëm, përgjegjshmëri dhe vullnet për t'u sjellë shqiptarëve produktet e sigurimeve me standarde europiane, Albsig është sot gjigandja vendase e tregut të sigurimeve e cila ka forcuar më së shumti rrënjët e saj. Prej vitesh njihet si një prej Shoqërive të sigurimit më me emër në tregun shqiptar. Jo rastësisht shënon 20 vite punë e përkushtim të palodhur për t'i kthyer tregut të sigurimeve, vlerën që i takon, por dhe një mirëqenie financiare e vetëbesim për konsumatorët. Brandi Albsig është suksesi që fsheh pas një emër dhe ai është emri i pronarit të saj z.Shefqet Kastrati, i cili e nisi aktivitetin e biznesit në fushën e sigurimeve në vitin 2004 me bashkëaksionerët e saj ku sot disponon pothuajse të plotë aksionet e kësaj kompanie.

Një shembull suksesi në këtë drejtim është Albsig, kompania e sigurimeve, e cila është future në të 20 vitet e ekzistencës së suksesshme në tregun e sigurimeve. Në dy dekada me përkushtim, ia doli që Albsig me brandin e saj ta kthejë në një emër familjar për shqiptarët. Gjithçka vetëm me korrektesë dhe angazhim maksimal, duke ndërtuar përgjatë 20 viteve edhe partneritet me emrat më të njohur ndërkombëtarë në tregun e sigurimeve. Ndërkohë, të ardhurat e kompanisë thuajse janë 10-fishuar gjatë 20 viteve në një treg ku konkurrenca është e lartë, shpesh edhe e pandershme.

Me Albsig që gjithmonë ka ecur me hapin e teknologjisë për të imponuar standarde në treg, duket se gjigandja e sigurimeve shqiptare e ka "pushtuar" tregun me produktet e saj cilësore dhe në shërbim të bizneseve e konsumatorëve. Me risitë që adoptoi, Albsig u shndërrua në një institucion "mësimor" në tregun shqiptar të sigurimeve dhe gjithçka ka ndikim pozitiv në mirëqenien e vendit, pasi produktet e sigurimeve janë mjaft të ndjeshme për financat e çdo familje shqiptare. Sektori i sigurimeve në Shqipëri është mjaft sfidues, kërkon një përkushtim dhe korrektesë të nivelit të lartë. Siç u theksua me lart, tashmë, Albsig renditet ndër kompanitë më të mira në treg. Dhe ky nuk është një perceptim, por konkluzion që del edhe nga mbikëqyrja dhe analiza e treguesve financiarë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Këta tregues shumë të mirë nxjerrin në pah punën e palodhur të kryer nga drejtuesit dhe i gjithë stafi.

Një nga synimet kryesore të Albsig.sh.a është rritja e mëtejshme dhe kryesimi në treg. Dhe me atë çfarë ka treguar ndër vite Albsig, me progresin që ka mundur të sigurojë kjo kompani, është e sigurtë që synime të tilla janë mëse të realizueshme. Kompania e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group, synon të jetë lideri kryesor në tregun e sigurimeve, të japë kontributin e vet në financat e çdo familje shqiptare për një jetë sa më të shëndetshme të komunitetit, të sigurojë një cilësi sa më të mirë në tregun e sigurimeve, sigurisht përmes përkushtimit të stafit të saj me përvojë. Orientimi i konsumatorëve dhe tregut në tërësi drejt produkteve vullnetare, ky është qellimi dhe arritja kryesore në treg për Shoqërinë e Sigurimeve Albsig. Që prej themelimit ALBSIG është ndër të paktat kompani në tregun e sigurimeve që ka ruajtur vazhdimisht një trend pozitiv në rritje dhe që vit pas viti ka konsoliduar pozitat në tregun e sigurimeve. Sigurisht, kjo rritje e vazhdueshme është dhe rezultat i investimeve dhe mbështetjes së vazhdueshme të Grupit Kastrati.

Rritja e vazhdueshme dhe konsolidimi i pozitave në tregun e sigurimeve, Albsig-ut i ka dhënë mundësinë që të jetë optimist për planet në të ardhmen dhe shumë shpejt të jetë kryesuese në treg. Falë arritjeve dhe mbështetjes së vazhdueshme të Grupit Kastrati, Albsig fokus investimesh ka infrastrukturën dhe cilësinë e shërbimeve dhe investim në kualifikimin dhe trajnimet e vazhdueshme të stafit. Krahas brandimit dhe forcimit të markës, shoqëria ka zgjeruar dhe modernizuar shërbimet në çdo pikë shitjeje, është investuar gjerësisht dhe në përmirësimin e shërbimeve online. Njekohësisht Albsig ka synuar dhe synon të ofrojë zgjidhje më të thjeshta, të cilat do të mund të përdoren lehtësisht nga klientët e Albsig në çdo kohë, 24 orë në 7 ditë të javës.

Si funksionon sot Albsig?

Kurse kohë dhe para, plotëso të dhënat online në më pak se dy minuta dhe merr sigurimin që të duhet ose paraqitu në njërin nga sportelet më të afërta të shoqërisë dhe merr menjëherë siguracionin e kërkuar. Bli sigurimin Online, në webfaqen e kompanisë apo paraqitu në çdo degë Albsig në çdo rreth të Shqipërisë.


Pse duhet të zgjidhni Albsig?

Do merrni oferta dhe përgjigje të shpejta, dëmshpërblim në kohë rekord. Menjëherë pas marrjes së kërkesës suaj, ekspertët e marrjes në sigurim do t'ju kontaktojnë. Do ta vlerësojnë kohën tuaj dhe do jenë të disponueshëm për ju. Do të përpiqen të plotësojnë nevojat e klientit gjatë orarit zyrtar në kontakt të drejtëpërdrejtë ose jo, nga ora 08:00 deri në 20:00 çdo ditë pune dhe të jenë në dispozicionin tuaj edhe në ditë pushimi.

Çmime të favorshme.

Përpara se të merni një vendim për sigurimet që ju duhen për ju dhe familjen tuaj duhet të informoheni sa më mirë. Kjo vlen dhe për të gjithë. Shumë shoqëri tregtojnë produkte të ndryshme sigurimesh dhe çmimet ndryshojnë shumë nga njëra te tjetra, kështu që, a ia vlen vërtet të blini te këto të fundit? Kur doni të blini një sigurim, merrni të paktën tre kuota çmimesh nga Shoqëritë e Sigurimit, agentë dhe nga interneti. Kështu do të bëni një studim tregu për llojin e sigurimit për të cilin do të jeni të interesuar. Në fund do të zgjidhni atë që ju përshtatet më mirë nevojave tuaja, me çmimin më të mirë. Dhe gjithçka që cilësuam më lart i plotëson vetëm shoqëria e sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group.





Soliditet Financiar.

Ju siguroheni për t'u mbrojtur financiarisht dhe për të siguruar qetësi mendore. Zgjidhni shoqërinë Albsig e cila është solide në treg, e shëndoshë financiarisht për shumë vite, e cila ka vlerësime nga agjensitë e pavarura të vlerësimit. ALBSIG, e autorizuar që në shtator të vitit 2004, u shërben klientëve të saj nëpërmjet një rrjeti të konsoliduar shitjesh i shtrirë në të gjithë Shqipërinë.


Shërbim me standarde ndërkombëtare.

Albsig dhe përfaqësuesit e saj do t'u përgjigjen pyetjeve tuaja dhe t'i trajtojnë kërkesat tuaja në mënyrë të drejtë, efikase dhe shpejt. Ju mund të kuptoni nëse një Shoqëri Sigurimi i ka këto veti duke folur me klientët e tjerë që kanë përdorur një shoqëri ose agjent të caktuar pjesë e Albsig. Ju gjithashtu mund të dëshironi të kontrolloni "reviews" nëse ka shumë ankesa për shoqërinë me të cilën dëshironi të siguroheni.

Qetësia shpirtërore e financiare.

Ju duhet të ndiheni të qetë me blerjen e një sigurimi të caktuar, pavarësisht nëse e blini atë nga një agjent lokal, drejtpërdrejt nga shoqëria, përmes telefonit apo internetit.

Sigurohuni që agjenti ose shoqëria do të jetë e lehtë për t'u arritur nëse keni një pyetje ose keni nevojë të paraqisni një kërkesë. Besimi i klientit në aftësinë për të përmbushur detyrimet ndaj tij, përbën bazën e suksesit për shoqërinë e sigurimit Albsig. Dinamizmi është fenomeni kryesor që përshkruan ALBSIG në aspektin e shërbimit të klientit. ALBSIG ka punuar vazhdimisht që proceset e klientëve të saj të jenë sa më efikase dhe të shpejta, duke përfshirë modernizimin dhe optimizimin e të gjitha proceseve, si dhe duke ofruar shërbime shumë cilësore.



 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL